


AL Udhëzime për përdorim



Arka për ftohje - ngrirje

Arka për ftohje - ngrirje

Ju falënderohemi për mirëbesimin tuaj që keni treguar duke blerë aparatin tonë.
Ju dëshirojmë kënaqësi tek përdorimi.

Aparati është i dedikuar vetëm për përdorim në amvisëri.

Arka për ftohje – ngrirje (në vijim aparati) përbëhet nga dy pjesë; pjesa e sipërme është frigorifer, kurse pjesa e poshtme arkë ngrirëse - ngrirës.

Frigoriferi është i dedikuar për përdorim në amvisëri, për ruajtjen e artikujve ushqimorë të freskët tek temperaturat më të larta se 0°C.

Ngrirësi është i dedikuar për përdorim në amvisëri për ngrirjen dhe për ruajtjen afatgjate të artikujve të freskët ushqimorë (deri në një vit, varësisht nga lloji i artikullit ushqimorë).

Vërejtje të rëndësishme	3
Këshilla për kursimin e energjisë elektrike te aparartet për ftohje dhe ngrirje.....	4
Përshkrimi i aparatit	5
Vendosja dhe aderimi.....	6
Ndryshimi i drejtimit të hapjes së derës.....	8
Komandimi i aparatit me rregullim elektronik	9
Komandimi i aparatit	15
Pajisja e brendëshme e frigoriferit.....	17
Ruajtja e artikujve ushqimorë në frigorifer	19
Ruajtja e art. ushqimorë në ruajtësin FreshZone ...	20
Ngrirja dhe ruajtja e art. ushqimorë të ngrirë	21
Shkrirja e aparatit	23
Pastrimi i aparatit	24
Evitimi i pengesave	25
Informata për zhurmën e aparatit.....	27

Vërejtje të rëndësishme

- Fëmijët e moshës tetë vjeçare e më shumë dhe personat me kapacitet të dobët fizik, sensorik dhe mental ose me njohuri dhe eksperiencë të mangshme, mund të përdorin aparatin në fjalë nën mbikqyrje adekuatë ose në qoftë se kanë marrë udhëzime të përshtatshme sa i takon përdorimit të aparatit dhe në qoftë se i kuptojnë rreziqet lidhur me përdorimin e aparatit. Nuk lejohet që fëmijët të pastrojnë aparatin dhe të ndërmarrin veprime për mirëmbajtje në të, pa mbikqyrje adekuatë. Rekomandimi i njejtë vlen edhe për përdorimin e aparatit nga ana e personave në mituri.
- Paraprakisht se të kyçni aparatin, nevojitet, që me kujdes të lexoni udhëzimet për përdorim. Ata e përshkruajnë aparatin dhe përdorimin e tij të rregullt dhe të sigurtë. Janë të përshtatura llojeve/modeleve të ndryshme të aparateve, prandaj, tek ata mund të jenë të përshkruara edhe rregullimet dhe pajimet të cilat aparati i juaj nuk i përban. Udhëzimet kyçin edhe realizimin e ngritës NO FROST, për t cilin është karakteristik ventilatori i instaluar dhe shkrija automatike.
- Evitoheni amballazhin i cili është i dedikuar për ruajtjen e aparatit, respektivisht për pjesët e posaçme në ndërkohë të transportimit.
- Për amballazhim përdorim materiale të pranueshme për mjedisin, të cilët, pa rrezik për te mund të përpunohen përsëri, deponohen ose të zhduken.
- Në këndet e derës (tek aparatet vetëqëndruese) ose në shtëpizën e aparatit (tek aparatet instaluese) janë të montuar distancues, të cilët evitohen, kurse në vendet e tyre vendoni tapotë e bashlangjitura.
- Paraprakisht se t'a aderoni në rrjetën elektrike, aparati le të jetë i qetë në pozicion vertikal së paku 2 orë. Kështu e zvogëloni mundësinë e funksionimit të çrregullt për shkak të ndikimit të transportimit në sistemin e ftohjes.
- Aderimi në rrjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit nevojitet të jenë të realizuara në ujdi me standardet dhe rregullat në fuqi.
- Nuk lejohet përdorimi i aparatit jashtë dhe se nuk lejohet të jetë nën ndikimin e shiut.
- Paraprakisht se të pastroni aparatin ose të ndëroni llambën e tij, atë patjetër shkyçni nga rrjeta elektrike (nxjerrni kabllonë kyçësë nga priza).
- Nëqoftëse kabloja kyçësë është e dëmtuar, atë nevojitet të ndërtojë serviseri ose personi i aftësuar.
- Nëqoftëse gjatë kohë nuk do të përdorni aparatin, shkyçni me pullë, pastaj e ndërpreni furnizimin me rrymë elektrike. Zbrazni aparatin, shkrijeni, pastaj pastroni dhe leni derën gjysëm të hapur.
- Për shkak të kujdesit ndaj mjedisit, aparatin e harxhuar dorëzoheni tubuesve të autorizuar të aparateve të harxhuara.
- Le të mos loz fëmia me aparatin.
- Mentesheja vetëmbyllëse e derës (e përbajnë vetëm disa modele) tekta para mbylljes tërheq derën kah shtëpiza dhe me këtë parandalon që të mos mbetet dera rastësisht e gjysëmhapur. Njëkohësisht kufizon këndin e hapjes së derës dhe me këtë ul mundësinë e dëmtimeve të elementeve fqinjë.
- Etiketa me të dhënat elementare për aparatin, gjendet në brendësi të aparatit. Në rast se nuk ju pëlqen etiketa me gjuhën e ngjitur, atë zavendësojeni me të bashkangjiturën.
- Vërejtje:** Hapësirat për ajrosje në aparat ose në elementin instalues, gjithmonë të jenë të pastërta dhe të lira.

- **Vërejtje:** Tek shkrija, mos përdorni ndihmesa mekanike ose metoda tjera, përveç atyre që parasheh prodhuesi.
- **Vërejtje:** Tek vendosja, pastrimi dhe evitimi i aparatit, kujdeseni që të mos dëmtoni izolimin, respektivisht pjesët e sistemit për ftohje. Me këtë e parandaloni edhe ndotjen e mjedisit.
- **Vërejtje:** Mos përdorni mbaresa elektrike në brendësi të aparatit përveç atyre që i lejon prodhuesi i aparatit.






Ky aparat përmban shënjen e aparaturave elektrike dhe elektroteknike sipas Udhëzimit 2002/96/EG (waste electrical and electronic equipment - WEEE). Udhëzimi jep kuadrin ligjor për te drejtën e kthimit mbrapsht të aparaturave të përdorura në të gjithë BE.

Këshilla për kursimin e energjisë elektrike te aparatet për ftohje dhe ngrirje

- Aparatin e poziciononi siç është përshkruar në udhëzime.
- Mos hapni derën e aparatit më shpesh se sa është e nevojshme.
- Kohë pas kohe kontrolloni që qarkullimi i ajrit pas aparatit të jetë i papengueshëm.
- Kondensatori në murinë e pasme të aparatit gjithmonë nevojitet të jetë i pastër (shiqo kapitullin Pastrimi i aparatit).
- Guarnicionin e dëmtuar ose joputhitës sa më parë ndërrojeni.
- Artikujt ushqimorë rruani në enët e mbyllura ose të ambalazhuara.
- Para se të konservohen, artikujt ushqimorë të ftohen në temperaturën e dhomës.
- Artikujt ushqimorë të ngrirë nevojitet të shkrihen në hapësirën e ftohjes.
- Evitoni sirtarët dhe derëzat në ngrirës siç është përshkruar në udhëzime, që të shfrytëzoni tërë vëllimin.
- Ngrirësin klasik e shkrihi pasi që në sipërfaqet e ftohura tubohet përafërsisht 3-5 mm ngricë, resp. akull.
- Rradhitja e rafteve nëpër hapësirë le të jetë e njëtrajtëshme, kurse artikujt ushqimorë të rradhitur ashtu që të sigurohet qarkullimi i papengueshëm i ajrit (merrni në përfillje rradhitjen e rekomanduar të artikujve ushqimorë siç është e përshkruar në udhëzime).
- Te aparatet me ventilator mos i mbuloni vanat e ventilatorit.

Përshkrimi i aparatit

Pajimet e brendëshme mund të ndryshojnë në bazë të modelit të aparatit.



A Frigoriferi

- 1 Ventilatori
- 2 Llambëza për ndriçimin e brendësisë së frig
- 3 Njësia komanduese
- 4 Bartësi i shisheve
- 5 Raftet ndarëse të shisheve
- 6 Rafti nxjerrës i qelqit (rregullues sipas lartësisë)
- 7 Rafti nxjerrës për meze
- 8 Bartësi lakues për vezë (i mbyllur për 6, i hapur për 12 vezë)
- 9 Sirtari FRESH ZONE
- 10 Enëzat për pemë dhe perime
- 11 Enëza në derën e frigoriferit (realizimet: e thellë, e cekët; me ose pa kapak)
- 12 Enëza për shishet me siguruës

B Ngjirësi

- 13 Sirtari për ruajtje
- 14 Sirtari për ngjirje
- 15 Këmbëza


Vendosja dhe aderimi

Zgjedhja e hapësirës

- Vendojeni aparatin në hapësirë të terët dhe të ajrshme. Ai funksionon me rregull tek temperaturat e rrethit të cilat shihen në tabelë. Klasa është e cekur në etiketën me të dhënat elementare për aparatin.


Klasa	Temperatura
SN (subnormale)	prej +10°C deri në +32°C
N (normale)	prej +16°C deri në +32°C
ST (subtropike)	prej +16°C deri në +38°C
T (tropike)	prej +16°C deri në +43°C

Vendosja e aparatit



Tek vendosja e aparatit, le të bashkëpunojnë së paku dy persona, që të parandalohen dëmtimet në aparat ose lëndimet e njerzve.

- Aparati le të qëndrojë rafsh dhe stabil në dyshe me mjaft të fortë.
Në anën frontale të aparatit gjenden dy këmbëza rregulluese (i përbajnë vetëm disa modele) me të cilat barazoni aparatin.
- Mos e vendoni aparatin nën ndikim direkt të rrezeve të diellit dhe mos e vendoni në afërsi të burimeve të nxehtës.
- Aparati mund të qëndrojë i pavarur ose e instaloni në elementin mobiljar. Pas aparatit nevojitet të jetë hapësirë e mjaftueshme për ftohjen e kondensatorit (distanca nga muria, resp. hapësirë prej 200 cm²). Largësia nga elementi mbi aparatin le të jetë së paku 5 cm.
Pas instalimit, resp. vendosjes, spina e aparatit nevojitet të jetë e arritshme!



Kujdes: te instalimi i aparateve në elementet mobiljare në mënyrë që ata qëndrojnë njëri pranë tjetrit (side by side), nevojitet të blehet dhe instalohet kompleti i servisit kundër vesimit! **Për shkak të sigurisë, ata nevojitet ta instalojë vetëm serviseri i autorizuar !**

Koda për porositje: 376078 (aparartet më të larta se 1700 mm)

- Aparatit vetëqëndruës janë bashkangjitur dy distancues të cilët caktojnë distancën e aparatit nga muria. Në bazë të largësisë së kondensatorit nga aparati, ata rrotullohen përkatësisht dhe vendosen në skajin e sipërm të tij.



Kyçja e aparatit

- Aparatin e kyçni në rrjetën elektrike me kabllonë kyçëse. Priza në muri nevojitet të përbajë kontakt tokëzues (prizë siguroese). Tensioni elementar i paraparë dhe frekuenca janë të cekura në etiketën me të dhënat elem. të aparatit.
- Kyçja në rrjetën elektrike dhe tokëzimi i aparatit, nevojitet të jenë të realizuar në ujdi me standardet dhe rregullat në fuqi.

Aparati përqëndron oscilime të shkurtëra nga tensioni elementar, por më së shumti prej -6% deri në +6%.


Ndryshimi i drejtimit të hapjes së derës

Aparati vetëqëndrues

Veglat e nevojshme; çelësi nr. 8, kaçavidhë, torx 25


Aparatin e menjanoni ashtu, që të mund të zhvidhoni menteshenë e poshtme dhe vazhdoni me zhvidhimin deri në fotosin 3, e prej atje e montoni në rradhitjen e kundërt. Përdorni kunjën e kundërt të menteshesë. Para vendosjes së menteshës së poshtme (sipërme), duhet që dera e pajisjes të jetë pak e hapur!

Tapotë e nxjerrura i përdorni në anën tjetër. Kontrolloni guarnicionin e derës. Në rast të mosputhitjes nxjerrni dhe rrotullojeni për 180°.




Komandimi i aparatit me rregullim elektronik

NJËSIA E KOMANDIMIT 1




NJËSIA E KOMANDIMIT 2

Aparati me no frost sistemin




- A Pulla rregullimi i temperaturës dhe kyçja/shkyçja e aparatit
- B Llambëza: ndriçon, kur funksionon aparati
- C Tasti për kyçjen e funksionimit intensiv të ventilatorit
- D Llambëza: ndriçon, kur është i kyçur ventilatori me buton
- E Tasti ngrirja intensive
- F Llambëza: ndriçon, kur funksionon rregullimi Ngrirja intensive
- G Indikatori digjital i temperaturës së frigoriferit tregon temperaturën faktike në aparat prej +1°C deri më +9°C

Kyçja/shkyçja e aparatit




Aparatin e kyçni ashtu, që pullën **A** e rrotulloni në drejtim të max. Aparatin e shkyçni, kur është pozicioni i thellimit në pullën te shenja  (aparati është akoma nën tension elektrik).

Përzgjedhja e temperaturës në frigorifer



- Temperaturën e dëshiruar e rregulloni me pullën **A**. Temperaturën e rregulloni në zonën e rregullimit prej **min.** deri në **max**.
- Rregullimi i preferuar i pullës së termostatit është pozicioni **eco**.
- Nëqoftëse temperatura e rrethit ku është i venduar aparati është më e ulët se 16°C, ose sasia e artikujve ushqimorë në ngrirës është më pak se 10 kg, rekomandojmë rregullimin e pullës së termostatit në **max**. Ventilatori le të jetë i shkyçur. Kjo është e nevojshme për sigurimin e temperaturës mjaft të ulët në ngrirës, kjo mundëson ruajtje afatgjate të artikujve ushqimorë të ngrirë.
- Te temperaturat më të larta nga ato të zakonshmet, rekomandojmë kyçjen e funksionimit intensiv të ventilatorit me tastin **C**.




- Indikacioni në indikatorin digjital gjatë rregullimit rreh, në ndërkohë sinjali zanor tërheq vërejtjen për çdo ndryshim të temperaturës së rregulluar. Kur ndërpritet rrehja, rregullimi i fundit rruhet në memorje.
- Te kyçja e aparatit, indikatorin digjital **G** rreh ca sekonda - tregon vlerën e rregulluar. Pastaj shihet vlera faktike, respektivisht vlera maksimale, e kjo shihet derisa temperatura në hapësirën e ftohjes përkatësisht nuk ulet.

Kyçja e funksionimit intensiv të ventilatorit (vetëm te njësia e komandimit 1)




- Me trusjen e tastit **C** kyçim funksionimin intensiv të ventilatorit (ndriçon llambëza **D**). Funksioni përdoret për uljen e vesimit të sipërfaqeve të brendëshme, diferencat temperaturiale ndërmjet të pjesëve të veçanta të aparatit dhe te temperaturat e larta të rrethit. Ventilatori funksionon vetëm te dera e mbyllur e frigoriferit.

Ngrirja intensive



- përdorni rregullimin vetëm te kyçja e parë e aparatit, para pastrimit dhe te futja e sasive të mëdha të artikujve ushqimorë. Kyçja e ngirjes intensive:
 - Njësia e komandimit 1: Aktivizoni tastin **E** (ndriçon llambëza **F**).



- Njësia e komandimit 2: Pullën **A** rrotulloni në pozicion (*).


Rregullimi shkyçet automatikisht pas dy dytësh.

***Alarmi te dera e hapur
e frigoriferit (vlen për
njësinë e komandimit 1)***

Në rast se dera është e hapur më shumë se 1 minutë, kyçet alarmi zanor. Ai shkyçet kur e mbyllni derën.

NJËSIA E KOMANDIMIT 3

Aparati me ventil dhe no frost sistemin



A Tasti për rregullimin e temperaturës së ngrirësit

B Indikator digjital i temp. së ngrirësit: tregon temperaturat prej -16°C deri në -24°C

C Tasti për kyçje/shkyçje të ngrirjes intensive

D Llambëza: ndriçon, kur funksionon rregullimi Ngrirja intensive

E Tasti për kyçje/shkyçje të aparatit (frigoriferit dhe ngrirësit)

F Llambëza: ndriçon, kur funksionon ngrirësi
G Tasti për shkyçjen e alarmit zanor dhe kyçje/shkyçje e mbrojtjes së fëmijëve.

H Llambëza: ndriçon kur është i aktivizuar alarmi

I Tasti për kyçje/shkyçje të frigoriferit

J Llambëza: ndriçon kur funksionon frigoriferi



K Tasti për kyçje/shkyçje të ftohjes intensive

L Llambëza: ndriçon kur funksionon rregullimi Ftohja intensive

M Indikator digjital i temperaturës së frigoriferit: tregon temperaturën prej +1°C deri më +9°C

N Tasti për rregullimin e temperaturës së frigoriferit

Kyçja/shkyçja e aparatit



Te kyçja e parë, së pari aderoni kabllonë kyçëse në prizë.


Në indikator shfaqen "vizat", të cilat tregojnë që frigoriferi dhe ngrirësi janë të shkyçur.

- Aparatin e kyçni/shkyçni me trusjen e tastit **E**, me zgjatje 3 sekondëshe.

Kyçen frigoriferi dhe ngrirësi, ndriçojnë llambëzat **F** dhe **J**. në këte gjendje mund të shkyçni vetëm frigoriferin me trusjen e tastit **I**, me zgjatje 3 sekondëshe (llambëza **J** shuhet).

- Në indikator shfaqet temperatura në frigorifer +9°C dhe në ngrirës 0°C. Vlerat në fjalë shfaqen derisa temperatura në hapësirën e veçantë nuk ulet nën këto vlera.
- Aparati është fabrikisht i pararregulluar në temperaturën e rekomanduar të frigoriferit +5°C dhe ngrirësit -18°C.


Përzgjedhja e temperaturës në aparat



Temperatura frigorifer varg:	Prej +1 °C deri në +9°C
Zona temperaturiale e rregullimit të ngrirësit	-16°C deri më -24°C + ngrirja intensive

- Temperaturën e ngrirësit e rregulloni me tastin **A**, kurse temperaturën e frigoriferit me tastin **N**.
- Kur trusni njërën nga tastet për rregullimin e temperaturës, indikacioni i temperaturës fillon të rreh dhe shfaq rregullimin e përzgjedhur më së fundi.
- Rregullimin e temperaturës e ndryshoni me trusjet e shkurtëra rradhëshe të tastit në hapa nga 1°C. Gjatë kohës së rregullimit, të gjitha tastet tjera janë të çmundësuar.
- Përafërsisht 5 sekonda pas lëshimit (mosveprimit) të tastit, temperatura e rregulluar memorohet. Në indikator shfaqet temperatura faktike në hapësirën e frigoriferit, resp. ngrirësit.

Rregullimet tjera




Sinjali zanor i pandërprerë – alarmi i derës së hapur

Nëqoftëse dera e frigoriferit është e hapur më gjatë se një minutë, aktivizohet sinjali zanor i **pandërprerë** dhe ndriçon llambëza **H**.

Alarmi zanor shkyçet pasi që e mbyllni derën ose me trusjen e tastit të alarmit **G**.

Sinjali - alarmi i temperaturës tejte të lartë të ngrirësit/ frigoriferit

Te temperatura tejte e lartësuar, aktivizohet sinjali zanor ndërprerës dhe rreh temperatura në indikator.



- Alarmin zanor e shkyçni me tastin **G**. Llambëza **H** dhe rrehja e temperaturës automatikisht shkyçen, pasi që ngrirësi/ frigoriferi ftohen mjaftueshëm që s'ka rrezik për prishjen e art. ushqimorë.
- Në rast se 24 orë pas shkyçjes së alarmit temperatura në ngrirës nuk arrin temperaturën e nevojshme, alarmi zanor kyçet përsëri. Automatikisht shuhet pasi që ftohet mjaftueshëm, që s'ka rrezik për prishjen e artikujve ushqimorë. Te kyçja e parë, aparati ka vonesë 24 orëshe të alarmit të temperaturës, që të parandalohet funksionimi i panevojshëm i alarmit.

Sinjali zanor i ndërprerë – alarmi për shkak të dështimit të tensionit

Nëqoftëse për shkak të dështimit të tensionit elektrik temperatura në frigorifer ose ngrirës lartësohet tepër, aktivizohet sinjali zanor (sinjal zanor i ndërprerë), ndriçon llambëza **H**, kurse në indikator rreh temperatura më e lartë e arritur (për frigorifer më së shumti 9°C).

Ftohja intensive

Me trusjen e tastit **K** aktivizohet rregullimi Ftohja intensive e frigoriferit (ndriçon llambëza **L**). Në këtë rast funksionon edhe ventilatori, por vetëm te dera e mbyllur e frigoriferit.

Pas 6 orësh shkyçet automatikisht, rregullimi kthehet në të pararregulluarën. **Është dedikuar për fohjen e shpejtë të sasive të mëdha të artikujve ushqimorë të palosura.**




Ngrirja intensive

Me trusjen e tastit **C** aktivizohet rregullimi Ngrirja intensive (ndriçon llambëza **D**). Fillon ftohja intensive e ngrirësit.

Në rast se rregullimin nuk e shkyçni me dorë, rregullimi shkyçet automatikisht pas dy ditësh së kyçjes. Rregullimi është i dedikuar për **ngrijen e shpejtë të sasive të mëdha të artikujve ushqimorë të palosur**. Në rast të dështimit të energjisë elektrike, procesi i ngrirjes së shpejtë përsëritet. Rregullimin e përdorni te kyçja e parë e aparatit, para pastrimit dhe te futja e sasive të mëdha të artikujve ushqimorë.


Mbrojtja e fëmijëve

Mbrojtja e instaluar për fëmijët mbron aparatit nga ndryshimet e padëshirueshme të rregullimeve temperaturiale ose më në fund edhe të shkyçjes së aparatit. Ate e kyçni/shkyçni me trusjen e tastit **G**, që zgjat 3 sekonda (në indikator rreh 3 sekonda 'LL' dhe 'L'). Kur është e kyçur mbrojtja, aktive është vetëm tasti për shkyçjen e alarmit, pas trusjes në cilëndo tast, shfaqen tekstet 'LL' dhe 'L'.




Komandimi i aparatit

Modeli pa ventilator




Modeli me ventilator




A Pulla e rregullimit të temperaturës dhe kyçje/shkyçje

B Tasti kyçje/shkyçje i ventilatorit (e kanë vetëm disa modele)

Kyçja/shkyçja e aparatit



Kyçja: pullën e termostatis rrotullojeni në drejtim të akrepit të orës kah pozicioni 7.





Shkÿcja: rrotullojeni pullën prapas në pozicionin **STOP (0)**.

Zgjedhja e temperaturës

- Te temperatura normale e rrethit, rekomandojmë rregullimin mesatar. Me pullën e termostatit mund të rregulloni temperaturën më të lartë ose më të ulët.
- Pozicionet e pullës në drejtim të 7 kanë domethënie të temperaturës më të ulët (më ftohtë) në të gjitha pjesët e aparatit. Temperatura në brendësi të frigoriferit mund të ulet edhe nën 0°C. Pozicionet kah 1 kanë domethënie të temperaturës më të lartë (më ngrohtë). Pozicionet kah 7 i përdorni vetëm kur është e rekomanduar dhe e dëshiruar temperatura e ftohjes ose temperatura e rrethit më e ulët se 16°C.
- Ndryshimi i temperaturës së rrethit ndikon në temperaturën në aparat. Kësaj nevojitet t'i përshtatet rregullimi i pullës së termostatit.
- Në pozicionin STOP (0) aparati nuk funksionon (sistemi ftohjes është i shkÿçur), por është nën tension (kur hapni derën e frigoriferit, ndriçon llambëza).

Ventilatori

(e kanë vetëm disa modele)



- Ventilatori kontribon te rradhitja e njëtrajtshme e temperaturave, ftohjes më të shpejtë dhe zbrit vesimin në sipërfaqet e palosjes. Funksionon vetëm kur funksionon edhe kompresori.
- Kyçjen e ventilatorit e rekomandojmë vetëm si funksion shpesë, edhe ate:
 - te ritja e temperaturës në ambient (mbi 30°C),
 - te ritja e lagështisë, respektivisht tubimi i pikave në raftet,
 - te palosja e sasive të mëdha të artikujve ushqimorë (ftohja e shpejtë).

• Kyçja/shkÿcja e ventilatorit

Shkÿcja = 

Shkÿcja = 0

Kujdes: Te ventilatori in kyçur ritet shpenzimi i energjisë dhe ulet temperatura në frigorifer. Prandaj, rekomandojmë rregullim të sërishëm të temperaturës në aparat:


- te ventilatori i kyçur: pozicioni 1-4,
- pa ventilator: pozicioni 4-7.

Regullimi i temperaturës në frigorifer në mënyrë indirekte ndikon në temperaturën e ngrirësit.

Pajisja e brendëshme e frigoriferit

(Pajisja varet nga modelet)

Rafti




Rafti ndarës nga qelqi

- Raftin mund të rradhitni sipas dëshirës nëpër udhëzues në brendësi të frigoriferit. Nëqoftëse dëshironi që ate të nxjerrni nga frigoriferi, së pari e tërheqni deri tek pika ku udhëzuesi e ndal, pastaj e çoni pak lartas dhe e nxjerrni nga frigoriferi. Artikujt ushqimorë që prishen shpejt i ruani në pjesën e fundit të raftit, ku është edhe më ftohët.


Në rast se ju nevojitet hapësirë për sendet e gjata (shishe, broqe,...), të cilët dëshironi t'i ruani në frigorifer, mund t'u gjeni vend në mënyrë, që pjesën e parë të raftit të lëvizni një nivel më poshtë dhe kështu të përfitonin vendin e nevojitur.

Bartësi i shisheve




Është i mbrojtur nga tërheqja. Ate mund të tërheqni vetëm të zbrazët, ashtu që në pjesën e fundit t'a çoni lartas dhe të tërheqni kah veti. Bartësin e instaloni ashtu, që gjatësia e shisheve të mos pengojë mbylljen e derës. Peshimi maksimal i bartësit është 9 shishe me përbërje prej 0,75l resp. 13 kg peshë të përbashkët – shiqo etiketën në anën e djathtë të brendësisë së aparatit.

Enët



- Ena në fundin e frigoriferit nën raftin prej qelqi është e dedikuar për ruajtjen e pemëve dhe perimeve. Mundëson lagështi dhe terje të ulët.

Ena e njëfishtë




- Nxjerrja e tërheqni:
 - Enën e tërheqni kah veti (në drejtim të shigjetës 1) – deri tek kufizuesi i derës. Në anën e kundërt të derës vazhdoni me nxjerrjen (në drejtim të shigjetës 2- rotacioni) dhe ngritjen e njëkohësishme (në drejtim të shigjetës 3).

Ana e brendëshme e derës së frigoriferit

Ventilatori

Sirtari tërheqës për meze



Rradhitja e preferuar e art. ushqimorë në aparat

- Janë të pajisura me hapësira (rafte ose enëza), të cilat janë të dedikuara për ruajtjen e djathit, tëlynit, vezëve, jkosit dhe sendve të ngjajshme, tubave, konservave dhe të ngj. Në pjesën e poshtme të derës gjendet hapësira për shishe.

- Ventilatori është i instaluar nën tavan ose i fshur në murin e fundit të frigoriferit (resp. i fshehur në njësinë ngrirëse), kontribon tek rradhitja e njëtrajtshme e temperaturave dhe ul vesimin në sipërfaqet për palosje.

Sirtari është përdorës para se të gjithash për meze të ftohta, djath, ... Sirtari tërhiqet në atë mënyrë, që në anën frontale të çohet pak lartë dhe pastaj të tërhiqet. Mbjatësin e sirtarit mund të lëvizim majtas dhe djathtas.

Pjesët e frigoriferit:

- **pjesa e sipërme:** ushqimi i konservuar, buka, verërat, ëmbëlsirat, ...
- **pjesa e mesme:** prodhimet e qumështit, artikujt ushqimorë të pregaditur, ëmbëlsirat, lëngjet, birrat, art. ushqimorë të zierë...
- **pjesa e poshtme:** mishi, prodhimet e mishit, bakallëku, ...
- **ena për perime:** pemët e freskëta, perimet, sallatat, ...

Pjesët e derës së frigoriferit:

- **pjesa e sipërme/mesme e derës:** vezët, tëlyni, djathi, ...
- **pjesa e poshtme e derës:** pijet, konservat, shishe, ...

Pjesët e ngrirës:

- ngrirje, ruajtje e artikujve ushqimorë të ngrirë, (shiqo kaptinën Ngrirja dhe ruajtja e artikujve ushqimorë të ngrirë).

Ruajtja e artikujve ushqimorë në frigorifer

Këshilla të rëndësishme për ruajtjen e artikujve ushqimorë

- Përdorimi i rregullt i aparatit, amballazhimi i mirë i artikujve ushqimorë, mirëmbajtja e temperaturës adekuate dhe marrja në përfillje e higjienës së artikujve ushqimorë, ndikojnë vendimtarisht në cilësinë e ruajtjes së artikujve ushqimorë.
- Merrni në përfillje afatgjatjen e artikujve ushqimorë në amballazh të prodhimit.
- Artikujt ushqimorë që i ruani në frigorifer, nevojitet të jenë në enë të mbyllura ose përkatësisht të amballazuara, që të mos lëshojnë ose pranojnë lagështi ose duhma.
- Mos ruani në frigorifer lëndë djegëse, avulluese ose shpërthyes.
- Shishet me përbërje të lartë të alkoolit le të jenë të mbyllura mirë dhe në pozicion vertikal.
- Disa tretësira organike, vajet eterike në lëvoret e limonave, portokajve, acidet në tëlyn dhe të ngj., tek kontakti i gjatëkohëshëm me sipërfaqet nga plastika ose me guarnicionin mund të shkaktojnë dëmtime ose vjetrim të parakohëshëm.
- Duhma e padëshirueshme ju tërheq vërejtjen në papastërti në aparat, eventualisht në përbërjen (shiqo kaptinën pastrimi i aparatit) e prishur.
- Nëqoftëse për gjatë kohë largoheni nga shtëpia, nxjerrni nga frigoriferi tërë ushqimin që priset shpejtë.

Koha e ruajtjes në frigorifer

Koha e preferuar e ruajtjes në frigorifer

Artikulli ushqimorë	Koha
vezët, marinadat, mishi i tymosur	deri në 10 ditë
djathi	deri në 10 ditë
rrënjëzat	deri në 8 ditë
tëlyni	deri në 7 ditë
ëmbëlsirat, pemët, gjellat e gatshme, mishi i freskët	deri në 2 ditë
peshku, mishi i freskët i prerë, pemët e detit	deri në 1 ditë



Ruajtja e art. ushqimorë në ruajtësin FreshZone

Në sirtarin **FreshZone** artikujt ushqimorë mbeshin më gjat kohë të freskëta se sa në frigoriferin e zakonshëm, ruajnë shijen dhe vlerat ushqimore.

Zvogëlohet mundësia e prishjes, humbja e vëllimit, kurse pemët dhe perimet janë më të freskëta dhe më natyrale.




Për funksionimin optimal, sirtari të jetë i mbyllur deri në fund.

- Kur bleni artikuj ushqimorë, kontrolloni se a janë të freskëta, nga kjo varet cilësia dhe afatgjatja e tyre.
- Ruani artikujt ushqimorë në enët e mbyllura ose të ambalazhuara në mënyrë të përshtatshme, që të mos lëshojnë ose marrin duhma dhe lagështi.
- 30-60 min para përdorimit nxjerrni artikullin ushqimor nga sirtari, që në temperaturën e dhomës të zhvillohen shija dhe aroma përkatëse.
- Artikujt ushqimorë që janë të ndjeshëm në temperatura të ulëta dhe nuk janë të përshtatshme për ruajtje në sirtare **FreshZone**: ananas, avokado, banana, vajulliri, patate, krastaveca, fasule, specia, shalqini, pjepër, kunguj,...
- Evitimi i sirtarit:
 - evitoni enën për perime;
 - evitoni raftin prej qelqi mbi, te disa modele edhe nën sirtarin FreshZone;
 - sipas nevojës (disa modele) evitoni derëzën e sirtarit (1): hapni, kapni në mes (siç shihet në fotos), lehtë i lakoni dhe njëkohësisht i tërheqni naltas, kah veti;
 - tërheqni sirtarin deri në pozicion siç tregon fotosi (detaji »A«), rrotulloni poshtas dhe evitoni;
 - futni sirtarin në vend të vet në rradhitje anasjelltase.



Ngrirja dhe ruajtja e art. ushqimorë të ngrirë

Proçesi i ngrirjes



- 24 orë para ngrirjes së artikujve ushqimorë të freskët, aktivizoni ngrirjen intensive.
 - **njësia e komandimit 1:** trusni tastin **E**,
 - **njësia e komandimit 2:** rrot. pullën **A** në pozicion (*);
 - **njësia e komandimit 3:** trusni tastin **C**
 - **rregullimi mekanik:** poz. i pullës ndërmjet të **4** dhe **6**.

Pas kësaj kohe, futni artikujt ushqimorë të freskët **në sirtarin për ngrirje**. Artikujt ushqimorë të freskët të mos fërkohen me pakotë e ngrira.

Tek NO FROST ngrirësit, nën tavan le të ketë mjaft hapësirë për qarkullimin e ajrit të ftohtë, prandaj, mos rradhitni artikuj ushqimorë më lart se kufiri i shenjuar i rradhitjes (shiqo fotosin).

- Pas 24 orësh artikujt ushqimorë mund t'i transferoni në sirtarin për ruajtje dhe sipas nevojës të përsëritni proçesin e ngrirjes. Sipas dëshirës, sirtarët mund t'i nxjerrni dhe artikujt ushqimorë t'i rradhitni në raftet ftohëse. Mos e evitoni sirtarin e poshtëm te NO FROST aparatet!
- Për ngrirjen e sasive të vogla të artikujve ushqimorë të freskëta (1-2 kg), rregullimi ngrirja intensive nuk nevojitet.

Këshilla të rëndësishme për ngrirjen e artikujve ushqimorë të freskët

- Në ngrirës të ngrini vetëm artikuj ushqimorë që janë të përshtatshëm dhe se mirë i rezistojnë temeperaurat e ulëta. Artikujt ushqimorë le të jenë me kualitet dhe të freskët.
- Zgjedhni ambalazh të përshtatshëm për artikullin ushqimorë dhe ambalazhoni me rregullsi.
- Ambalazhi nuk guxon të lëshojë ajrin dhe lagështinë, që të mos shkaktojnë terjen e përbërjes dhe humbjet e vitaminave.
- Artikujt ushqimorë të ambalazhuar i shenjoni me të dhënat për llojin dhe sasinë e artikullit ushqimorë dhe datën e ngrirjes.
- Është e rëndësishme, që art. ushqimorë sa më parë të ngrijnë, prandaj, rekomandojmë që paketë të mos jenë të mëdha dhe se artikujt ushqimor para radhitjes të ftohen.
- Sasia e artikujve ushqimorë të freskët e cila mund menjëherë të radhitet është e cekur në etiketën me të dhënat elementare të aparatit. Nëqoftëse është sasia e madhe, kualiteti i ngrirjes është i dobët, por, dobësohet edhe cilësia e artikujve ushqimorë që ngrihen.

Ruajtja e artikujve ushqimorë industrial të ngrirë

Në ambalazh të artikujve ushqimorë industrialisht të ngrirë janë të shënuar koha dhe temperatura e ruajtjes. Tek ruajtja dhe përdorimi nevojitet të merni në përfillje udhëzimet e prodhuesit të artikujve ushqimorë. Zgjedhni vetëm artikujt ushqimorë të ambalazhuar mirë dhe të pajisura me të dhënat e plota dhe të ruajtura në ngrirës, në të cilët është së paku -18°C. Mos bleni artikuj ushqimorë me ngricë, sepse, ata kan qenë të shkrija shumë herë. Artikujt ushqimorë mbron nga shkrija, sepse, rritja e temperaturës u shkurtton kohën e ruajtjes dhe dobëson kualitetin e tyre.

Koha e ruajtjes së artikujve ushqimorë të ngrirë

Koha e rekomanduar për ruajtje në ngrirës

Artikulli ushqimor	Koha
pemët, mishi i lopës	prej 10 deri në 12 muaj
perimet, mish viçi, shpendia	prej 8 deri në 10 muaj
egërsira	prej 6 deri në 8 muaj
mishi i derit	prej 4 deri në 6 muaj
mishi i prerë	4 muaj
buka, ëmbëlasirat, gjellat e gatshme	3 muaj
imtësirat e mishit	2 muaj
suxhuku i tymosur, peshku u yndyrshëm	1 muaj

Shkrija e artikujve ushqimorë të ngrirë

Artikujt ushqimorë të shkrië sa më parë të harxhohen. Ngrirja i konservon, por, nuk i zhdruk mikroorganizmet të cilët, pas shkrijës me shpejtësi aktivizohen dhe e prishin artikullin ushqimor. Shkrija e pjesërishtme ul vlerën ushqimore të artikujve ushqimorë, posaçërisht pemëve dhe perimeve si dhe gjellave të pregaditura.

Shkrirja e aparatit

Shkrirja automatike e frigoriferit

Frigoriferi nuk nevojitet të shkrihet, sepse, akulli në murinë e fundit shkrihet automatikisht.

Akulli që shkaktohet në murinë e fundit në ndërkohë të funksionimit të kompresorit, në kohë të mosfunksionimit të tij shkrihet dhe në formë të pikave kullon poshtë, pastaj, nëpër hapësirë në murinë e fundit të frigoriferit rrjedh në enëzën mbi kompresor, ku avullohet. Në rast se në murinë e fundit të brendësisë së frigoriferit tubohet shtresa e tepërt e akullit, (3-5 mm), shkyçni pullën dhe shkrijeni me dorë.

Shkrirja e ngrirësit klasik

- Ngrirësin e shkrihi pasiqë tubohet për afërsisht 3-5 mm ngricë.
- 24 orë para shkrijës aktivizoni ngrirjen intensive (shiqoni kaptinën Komandimi në bazë të realizimit të aparatit - Ngrirja intensive), që artikujt ushqimorë të ngrijnë shtesë. Pas kësaj kohe, artikujt ushqimorë i nxjerrni nga ngrirësi dhe mbron i që të mos shkrihen.
- Shkyçni aparatit (shiqoni kaptinën Komandimi kyçje/shkyçje e aparatit) dhe nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza.
- Në fundin e ngrirësit vëni recka ujëthithëse për ujin e shkrire dhe koh pas kohe i ndëroni.
- Mos shkrihi aparatit me mbaresat elektrike (terësi i flokëve dhe të ngj.) – **rrezik me vdekje!**
- Tek shkrirja, mos përdorni aerosolet për shkrijë, sepse, ata mund të shkrijnë pjesët nga plastika, resp. dëmtojnë shëndetin.
- Brendësinë e aparatit e pastroni dhe e terni (shiqoni kaptinën Pastrimi i aparatit).

Shkrirja e ngrirësit NO FROST


- Shkrirja e ngrirësit NO FROST është automatike. Paraqitja e kohë pas kohëshme e ngricave zhduket automatikisht.
 - Shfaqja e akullit, respektivisht shtresave të ngricës në pjesën për ngrirje, mund të jetë pasojë e përdorimit abnormal të aparatit (hapja e shpeshtë e derës, dera e hapur gjatë kohë, dera jo e mbyllur mirë,). Në këto raste shkyçni aparatit, nxjerrni artikujt ushqimorë nga ngrirësi dhe siguroni që të mos shkrihen.
- Pastroni dhe thani brendësinë e ngrirësit, kurse, paraprakisht se të futni artikujt ushqimorë në ngrirës, aparatit e kyçni dhe përzgjedhni rregullimin e dëshiruar.

Para pastrimit, aparatin shkyçni nga rrjeta elektrike


(shiqoni kaptinën Komandimi kyçje/shkyçje e aparatit) dhe nxjerrni kabllonë kyçëse nga priza.

Tek pastrimi, nevojitet të jeni të kujdesshëm që të evitoni të gjithë mbeturinat e lëndëve pastruese.


- **Jashtësinë** e aparatit e pastroni me ujë dhe detergjent fluid.
- Për pjesët plastike, të lustruara dhe alumine mos përdorni lëndë pastruese të vrazhdëta, abrazive, ose lëndë speciale agresive për pastrim (siç janë lëndët pastruese për teneqenë jokoroduese), që të mos dëmtoni sipërfaqen.
- Sipërfaqet e lustruara dhe ata të aluminës mund të pastroni me reckë të butë dhe lëndë pastruese në bazë të alkoolit (p.sh. lëndë pastruese për qelq).
- **Brendësinë** e aparatit dhe pajimet i pastroni me detergjentin e rralluar fluid dhe ujë të vokët, kësaj mund t'i shtoni pak uthull.
- Enët, raftet dhe sirtarët të cilat përbajnë profil dekorativ (pamje metalike), nuk janë të përshtatshëm për pastrim në makinën për pastrimin e enëve! Ata mund të pastrohen vetëm me detergjentin e rralluar fluid dhe reckën e butë. Nuk lejohet fërkimi!



- Nën pllakën e ftohjes e cila ftoh brendësinë e friigoriferit, gjenden olluku dhe hapësira ku rrjedh uji i shkrirë. Olluku dhe hapësira nuk lejohet të jenë të shtupuara (p. sh. me mbeturinat e ushqimit), prandaj, ata shpesh herë kontrolloni dhe sipas nevojës pastroni (p. sh. me pip nga plastik).






- **Kondensatori** në murinë e fundit gjithmonë të jetë i pastërt, pa pluhur ose mbeturira tjera nga tymi kuzhinor. Me furçë të butë jometalike ose me thithësin për pluhur, kohë pas kohe pastroni pluhurin.



- Pastroni edhe **enëzën** mbi kompresorin e frigoriferit. Nëqoftëse ate e keni evituar, pas pastrimit vëni në vendin paraprak. Kujdeseni që të qëndrojnë në pozicion horizontal!
- Shtresat e ngricës, resp. të akullit me trashësi prej 3-5 mm lartësojnë shpenzimin e energjisë elektrike, prandaj, gjithmonë rregullisht të evitohen (nuk vlen për ngrirësin NO FROST). Mos përdorni sende të prehta, lëndë shkrirëse dhe aerosole.
- Pas pastrimit kyçni aparatin dhe palosni artikujt ushqimorë.

Evitimi i pengesave

Pengesa:	Shkaku, resp. evitimi
Pas kyçjes në rrjetën elektrike, aparati nuk punon:	Kontrolloni se a ka tension në prizë dhe a është aparati i kyçur.
Sistemi i ftohjes gjatë kohë punon pandërprerë: 	- Temperatura tejet e lartë e rrethit. - Hapja e shpeshtë e derës, resp. dera e hapur gjatë kohë. - Dera e mbyllur me çrregullim (mundësia e diçkasë ndërmjet të derës, dera e varur, kontrolli i guarnicionit, etj.). - Palosja e sasisë tejet të madhe të art. ushqimorë të freskët. - Sensori në frigorifer (A) (e përbajnë vetëm disa modele) i mbuluar me artikuj ushqimorë të freskët. Mundësoni që rreth sensorit të qarkullon ajri. - Ftohja e pamjaftueshme e kompresorit dhe kondensatorit. Kontr. qarkullimin e ajrit pas aparatit dhe pastroni kondensat.
Tubimi i tepërt i akullit në murinë e fundit të brendësisë së frigoriferit është pasojë e:	- Hapjes së shpeshtë të derës, resp. dera e hapur gjatë kohë. - Futja e ushqimit të ngrohtë në frigorifer. - Ushqimi ose ena fërkohet në murinë e fundit në brendësi. - Guarnicioni jo i mirë. - Nëqoftëse guarnicioni është i ndotur ose i dëmtuar, atë pastrojeni ose ndëroni.
Shfaqja e akullit, respektivisht shtresave të ngjirës në ngjirës është pasojë:	- Hapja e shpeshtë e derës, respektivisht dera e hapur gjatë kohë. - Dera jo e mbyllur mirë. - Guarnicioni i dobët i derës. - Nëqoftëse guarnicioni është i ndotur ose i dëmtuar, atë pastroni, respektivisht ndëroni.
Uji rrjedh nga frigoriferi:	- Uji rrjedh nga frigoriferi, nëqoftëse është shtupuar hapësira për daljen e ujit ose nëqoftëse uji i shkrirë rrjedh atypari ollukut. - Pastroni hapësirën e shtupuar, p. sh. me pip nga plastika. - Shtresën e trashë të akullit e shkrini me dorë (shiqoni kaptinën Shkrirja e aparatit).
Llambëza H rreh: (vetëm për pjesën ngrirëse të aparatit)	- Hapja e shpeshtë e derës, resp. dera gjatë kohë e hapur. - Dera e mbyllur me çrregullsi (diçka gjendet mes derës, dera e varur, guarnicioni i dëmtuar,...). - Gjat kohë nuk ka pasur energji elektrike. - Palosur sasia e madhe e artikujve ushqimorë të freskët.
Hapja e derës e vështirësuar:	Nëqoftëse dëshironi të hapni derën e posambjllur të ngrirës, mund të ndodh që këto të veproni me vështirësi. Në ndërkohë të hapjes së derës, ca ajr të ftohtë del nga aparati, ai zëvendësohet me ajr të ngrohtë nga rrethi. Këtu shkaktohet nënshtypje, e kjo është shkak për hapjen e vështirësuar të derës. Pas ca minutash, gjendja normalizohet dhe derën mund të hapni pa vështirësi.

Pengesë:	Shkaku, resp. evitimi
Ndërimi i llambës: A  B 	- Paraprkishtë se të ndëroni llambën, patjetër ndërpreni furnizimin e aparatit me energji elektrike (nxjerrni kabllo të kyçës nga priza). - A - Me ndihmën e kaçavidhës (në drejtim të shigjetës) trusni dhëmbëzin kërcyes dhe evitoni kapakun. - B- Kaçavidhën vendosni në vanën e kapakëzës, çonja lartas dhe nxjerrjeni. Ndëroni llambëzën me të re (E 14, me fuqi të njejtë siç ajo e instaluar fabrikisht) dhe vendosni kapakun përsëri në vend të vet. - Llambëzën e djegur mos e hudhni në mbeturinat organike! - Llambëza është material shpenzues dhe se garancioni ynë për të nuk vlen! - Llambat që janë përdorur në këtë aparat, janë llamba të posaçme, të dedikuara vetëm për përdorim në aparatet e amvisërisë. Këto llamba nuk janë të përshtatshme për ndriçimin e hapësirave banesore ose në amvisëri.
Llambëza B rreh:	Në rast se rreh llambëza B, thirrni serviserin.
Shfaqja e kodës së gabimit në indikator (e kanë vetëm disa modele):	Në rast se në indikator shfaqet E, thirrni serviserin.

Nëqoftëse asnjë nga shkaqet e lartcekura nuk përgjigjet, thirrni servisin më të afërm të autorizuar dhe cekni tipin, modelin dhe numrin serik nga etiketa me të dhënat elementare për aparat, e cila gjendet në brendësi të aparatit.

Ftohjen në aparatet për ftohje-ngirirje mundëson sistemi për ftohje me kompresor (tek disa modele edhe ventilatori), e kjo shkakton edhe zhurmë të caktueshme. Lartësia e zhurmës varet nga vendosja, përdorimi i rregullshëm dhe moshës së aparatit.

- **Pas nisjes** së aparatit, punimi i kompresorit (zhurma fluide) resp. qarkullimi i lëndës ftohëse është më zë më të lartë. Kjo nuk është shenjë e prishjes dhe nuk ka ndikim në jetëzgjatjen e aparatit. Pas një kohe të punimit të kompresorit, lartësia e kësaj zhurme ulët.
- Tek punimi i aparatit, disa herë mund të paraqiten edhe **zhurma të ndryshme dhe të fuqishme**, këto janë për aparatin të jashtzakonshme dhe se më së shpeshti janë pasojë e vendosjes jo të përshtatshme:
 - Aparati le të qëndrojë në dysheme të rrafshë, stabile dhe të fortë.
 - Le të mos preket me murinë ose elementet fqinjë.
 - Kontrolloni se a gjenden pajimet e brendëshme në vend të vet, resp. të mos bëjnë rrapallimë konservat, shishet ose enët tjera kur fërkohen ndërmjet veti.

MARRIM TË DREJTË PËR NDRYSHIME, TË CILAT NUK
NDIKOJNË NË FUNKSIONIMIN E APARATIT.

Udhëzimet për përdorimin e aparatit mund t'i gjeni edhe në WEB
faqen tonë: www.gorenje.com / < <http://www.gorenje.com> />

363937

